



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

ZËDHËNËSI

---

Tiranë, më 07 Janar, 2014

*Njoftim për Shtyp*

**KLSH PADIT NË PROKURORI**  
**ISH-DREJTUESIN DHE 6 NËPUNËS TË ZVRPP KORÇË**  
**PËR “SHPËRDORIM DETYRE”**

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përfundim të auditimit të ushtruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme - Korçë për periudhën e veprimtarisë 2011-2012, ka dërguar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, kallëzim penal për shtatë nëpunës të këtij institucioni, përfshirë këtu edhe ish-Regjistruuesin K.B., të cilët në kundërshtim të plotë me legjislacionin për regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe aktet e tjera nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, kanë kryer një sërë shkeljesh në drejtim të regjistrimit të pasurive të paluajtshme me pasojë përfitime të paligjshme të titujve të pronësisë nga subjekte private në dëm të pasurisë shtetërore dhe konkretisht:

Nga auditimi rezultoi që këta nëpunës kanë kryer regjistrime të pasurive të paluajtshme dhe kanë lëshuar çertifikata të pronësisë në zonën rurale-urbane, për një sërë subjektesh private, të cilat nuk kanë patur asnjë titull pronësie. Kështu, në 11 raste këta persona kishin regjistruar më tepër një sipërfaqe prej **4400 m<sup>2</sup>** të llojit arë, truall dhe arë+truall, ku në veçanti, vetëm **për zonën turistike të Voskopojës janë dhënë në kundërshtim me ligjin 1,960 m<sup>2</sup>**.

Kjo sipërfaqe e tepërt, e regjistruar nga këta punonjës në favor të subjekteve përfitues dhe në tejkalim të normës ligjore të përcaktuar në Aktet e Marrjes në Pronësi të Tokës (AMTP), bie në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, i ndryshuar, ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, UKM nr. 2, datë 08.04.2009, UKM nr. 1, datë 31.01.2007 “Për Procedurat e Regjistrimit në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, rregulloren e ZQRPP-së, VKM nr. 1025, datë 09.07.2008, si dhe Urdhrin e K/Regjistruesit nr. 1400, datë 25.10.2010.

Për pasojë, Kontrolli i Lartë i Shtetit, nisur nga shkalla e lartë e dëmit të shkaktuar ndaj pasurisë shtetërore dhe shkeljet e rënda që këta nëpunës të ZVRPP, Korçë kanë kryer në tejkalim të kompetencave të tyre ligjore, përgatiti dhe depozitoi pranë organit të prokurorisë, kallëzimin përkatës për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga nenin 248 i Kodit Penal, duke rekomanduar njëkohësisht institucioneve përgjegjëse edhe largimin e menjëhershëm nga detyra të këtyre nëpunësve.